



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i mbledhjes së tretë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 18.3.2025, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Arton Brahimi, Adnan Ajeti, Faton Marolli, Nenad Miladinovic, Kimeta Shok dhe Oktay Kurtesh.

Munguan: Elmira Nikçi – Rexha dhe Tiera Kasumi – Berisha.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Fisnik Dida, zyrtar nga OSBE-ja, Arianita Beqa - Rraci - zyrtare nga UNMIK-u, Slavica Stoliq, zyrtare nga ZKKK, Betim Abdullahu, zyrtar nga ZKKK, Lindita Hajdari, zyrtare nga Drejtoria e Kulturës dhe Habib Qorri, zyrtar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj. Mirsada Behluli, kryesuese e komitetit, me këtë

Rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit të Komitetit për Komunitete;
2. Ftesë e kryesuesit të Kuvendit për mbledhjen e KK-së;
 - a) Koordinimi i punës me ZKKK-në, duke informuar për nevojat dhe problemet e komunitetit joshumicë;
3. Thirrje për Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:
 - a) Analiza e projekteve të komuniteteve joshumicë;
4. Thirrje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike:
 - a) Diskutim i sfidave në rajonet e banuara nga komunitetet joshumicë;
 - b) Koordinimi i përbashkët i aktiviteteve gjatë vitit 2025;
5. Thirrje për Drejtorinë e Kulturës, lidhur me festat kombëtare për komunitetet joshumicë dhe të tjera;
6. Raporti i ZKKK-së për muajin shkurt 2025;
7. Raport nga komunitetet joshumicë për gjendjen në bashkësinë e tyre;
8. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit të Komitetit për Komunitete.

Mirsada Behluli, kryesuese bëri vërejtje në pikën e katërt të rendit të ditës e cila tha se: Grupi është formuar që të bënë një vizitë në Ministrinë për Kthim, e jo të bëjë vizitë te Zyra e kryeministrit për Komunitete. Me vërejtjen e dhënë, kryesuesja konstatoi se, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së fundit të Komitetit për Komunitete.

Pika e dytë

Ftesë e kryesuesit të Kuvendit për mbledhjen e KK-së. a) Koordinimi i punës me ZKKK-në, duke informuar për nevojat dhe problemet e komuniteti joshumicë.

Në mungesë të kryesuesit të Kuvendit, kryesuesja e komitetit tha se kjo pikë shtyhet për shqyrtim për mbledhjen e radhës së komitetit.

Pika e tretë

Thirrje për Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave: a) Analiza e projekteve të komuniteteve joshumicë;

Në mungesë të drejtorit të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, kryesuesja e komitetit tha se kjo pikë shtyhet për shqyrtim për mbledhjen e radhës së komitetit.

Pika e katërt

Thirrje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: a) diskutimi i sfidave në rajonet e banuara nga komunitetet joshumicë; b) koordinimi i përbashkët i aktiviteteve gjatë vitit 2025;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesja tha se anëtarët e Komitetit për Komunitete kanë pasë vërejtje me punët që i kryen Drejtoria e Shërbimeve Publike, kryesisht rreth grumbullimit të mbeturinave në disa fshatra të banuara me komunitetet joshumicë, po ashtu me deponitë ilegale kryesisht përgjatë rrugës Mazgit – Bërnice. Probleme me mos grumbullimin e mbeturinave kanë edhe banorët në lagjen “Kalabria”, banorët afër rrugës “Sylejman Vuçitërna” dhe kërkesë e qytetarëve është që të rritet numri i lokacioneve me kontejnerë. Po ashtu këto komunitete kanë pasë vërejtje me problemin e ndriçimit për rrugën “Bajram Kelmendi” në lagjen “Tophane”, si dhe për rrugën “Lidhja e Lezhës” në fshatin Slivovë. Gjithashtu është më se e domosdoshme që të vendosen ulëset nëpër satcionët e autobusëve si në lagjen “Kalabria” edhe në vende të tjera të cilat kanë nevoja për të njëjtat gjëra. Nenad Miladinoviq tha se sa i përket çështjes së grumbullimit të mbeturinave ne po kemi probleme të mëdha, në veçanti për krijimin e deponime ilegale në fshatin Bërnice dhe në rrethinë. Kërkoj nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Habib Qorri që, të dalin në teren, të shohin atë gjendje kautike dhe ajo deponi të pastrohet, ku aq shumë është përhapë sa që ka shkuar deri në asfalt. Tani po hedhin edhe kafshë të ngordhura, material ndërtimor dhe ka më se tre vjet dhe nuk është bërë pastrimi i ambientit prej këtyre mbeturinave. Po ashtu është më se e domosdoshme edhe pastrimi i shtartit të lumit si dhe ndriçimi i rrugëve në këtë lokalitet.

Habib Qorri tha se, kohëve të fundit jemi duke u ballafaquar me problemin për mbeturinat dhe sa i përket deponive ilegale, ne çdo vit kemi hartuar plan për largimin e tyre, kështu që ne kemi parë që vitin e kaluar ka qenë deponia më e madhe ilegale për gjatë autostradës në Besi, por për shkak të pajisje teknike jo të mjaftueshme dhe të mjeteve buxhetore, nuk është arritë të pastrohet. Tani jemi duke e përgatitë Sektorin për menaxhimin e mbeturinave për largimin e deponive ilegale dhe unë do t'i mbartë të gjitha këto shqetësime, në mënyrë që të hyjë këto në plan për pastrim. Sa i përket ndriçimit të rrugëve në shumë lagje të qytetit, kemi kohë të gjatë që jemi pa kontratat e mirëmbajtjes për shkak të procedurave të prokurimit dhe disa procedurave tjera. Mirsada Behluli, falënderoi për prezencën e përfaqësuesit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për interesimin e shprehur në zgjidhjen e shumë problemeve, si për largimin e deponive ilegale, pastrimin e lumit dhe për ndriçimin e rrugëve.

Pika e pestë

Thirrje për Drejtorinë e Kulturës, lidhur me festat kombëtare për komunitetet joshumicë dhe të tjera.

Linda Hajdari tha se si çdo vit edhe këtë vit drejtoria lanifikon që ti përkrah projektet e komuniteteve joshumicë të cilat aplikojnë dhe normalisht dhe i kanë përmbush kërkesat. Thirrjet bëhen përmes faqes zyrtare të Komunës dhe ne si drejtori çdo muaj e publikojmë kalendarin kulturor që është i hapur në rrejte sociale dhe normalisht sipas kërkesave që vijnë mundohemi çdo herë me ju ndihmuar në aspektin institucional. Mirsada Behluli, kryesuese tha se Zyra për komunitete do të na njoftoj për ftesën e hapur. Fatos Marolli tha se ne në fillim të vitit i drejtohem drejtorive përkatëse se për të cilat aktivitete kemi nevojë për përkrahje, për shkak se realisht kabineti neve nuk na ka ofruar asnjëherë ndonjë shumë të caktuar, që ne si zyre me mundur me i përkrah direkt kurdo që janë datat ose festat, kështu që do të ishte mirë që Drejtoria e Kulturës ta ket një kalendar kurdo që janë muajt e festave me i reklamuar, që secili që e ka festën kombëtarë me e bë një program me e shfaq kulturën, traditën, zakonet të atyre komuniteteve të cilën e kanë ditën ose festën kombëtare. Mirsada Behluli, kryesuese tha se do të ishte mirë që secili prej neve të tregoj se cila është festë e komunitetit të vetë. Fatoni Marolli tha se, festa zyrtare e komunitetit ashkali është më 15 shkurt. Oktay Kurtesh tha se, 23 prilli është dita e turqve. Adnan Ajeti tha se, dita e romëve është më 8 prill. Nenad Milladiniviq tha se ka një interesim të madh për organizimin e një eskurzioni në territorin e Kosovës, por është vetëm në pyetje pagesa e transportit dhe nuk e di si është mënyra që të realizohet ky organizim. Kimeta Shok tha se dita e goranëve është 6 maji dhe ne as një herë nuk kemi aplikua për ndonjë organizim, nuk e dimë a ka buxhet ku duhet dhe kujt duhet ti drejtohem për ato ditë. Linda Hajdari tha se në kategorinë subvencioneve hapet thirrja për festivale, organizime, manifestime, ku bëhen përmes thirrjeve publike. Mirsada Behluli, kryesuese tha se organizata jo qeveritare "Humana", është organizatë multi-etnike, mundeni të kontaktoni me këtë organizatë që të ju përkrahë lidhur me festat kombëtarë. Linda Hajdari tha se, për me e përkrahë një projekt duhet me pas linjë buxhetore të planifikuar. Mirsada Behluli tha se sa i përket fetsës së drejtorëve të drejtorive përkatëse, që nga sot do të jetë një vërejtje për mos prezencën e tyre në mbledhjen e komitetit. Për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, kam përgatitur një raport ku janë të paraqitura disa probleme lidhur me infrastrukturën e lokaliteteve ku janë komunitetet jo shumicë, kështu që ne si komitet do ti paraqesim brengat e atyre qytetarëve të cilët kanë nevojë për ndihmë nga kjo drejtori.

Pika e gjashtë

Raporti i ZKKK-së për muajin shkurt 2025.

Mirsada Behluli, kryesuese tha se e kam përgatitur një raport të shkurtër për problemet dhe nevojat tona. Ky raport pasqyron shumë probleme të cilat kryesisht ndërlidhen me Drejtorinë e Investimeve Kapitale, kryesisht rreth rregullimit të infrastrukturës në ato lokalitete të komuniteteve joshumicë, si në rregullimin e rrugëve, rrjetit të kanalizimi etj. Po ashtu në këtë raport i kam paraqitur disa probleme që kanë të bëjnë me komunitetin turk dhe serb, lidhur me dokumentacionin personal me gabime gjuhësore, kur është fjala për emrin, mbiemrin dhe shënime të tjera. Përfaqësuesi i komunitetit turk ka kërkuar që të hapet një çerdhe në lagjen "Tophane" dhe të përkrahet transporti për 80 nxënës të komunitetit turk që udhëtojnë më shumë se 5 kilometra për me ardhur në shkollë në gjuhën turke në Prishtinë.

Probleme me mjete të arsimit, me libra se nuk janë të përkthyer për komunitetin turk në gjuhën turke si dhe për gjuhën boshnjake. Nenad Milladinoviq, përfaqësues i komunitetit serb ka paraqitur një problem që ka ndodhur në Bërnice, i cili tha se, ka ndodhë një problem shumë i madh, është sulmuar një person në shtëpinë e vetë nga një person i komunitetit shqiptar i cili pretendon se kinse ai e ka blerë atë parcelë, por në atë parcelë ekziston shtëpia e familjes Vaniç të cilën ata e kanë ndërtuar që nga viti 1960 dhe jetojnë në atë shtëpi. Lidhur me këtë problem kam kërkuar që familja të jetë e mbrojtur nga sulmuesit, sepse nuk mundem të besoj se dikush të bëjë ashtu sulm ndaj një familje, ndaj fëmijëve, çka është më e keqja ai jeton në atë shtëpi me dritare të dëmtuara, sepse nuk ka ku të jetoj. Betim Avdullahu tha se për këtë rast kemi biseduar në Komitetin për Siguri në Bashkësi dhe do të marrim të gjitha masat që këtë problem ta zgjidhim përmes organeve përkatëse që janë kompetentë për zgjidhjen e problemeve të tilla.

Takimi i radhës do të mbahet më 18.4.2025.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesja e komitetit
Mirsada Behlu**

